



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:045347

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05956756

C.nr.915/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të paditësit S (I) G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson avokati G.Sh nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurve: G (I) M, e lindur K, S (I) K, M (I) K, M.S, Sh.R, dhe A.H, që të gjithë nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson M (I) K nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 1,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 19.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit S (I) G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET se paditësi S (I) G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.00273-2, ZK Sapniq, pronë private, vendi i quajtur “Rezina”, me kulturë ”Bujqësore - Arë e klasës 6”, në sipërfaqe të përgjithshme tekstuale prej 460 m², e cila kufizohet në anën veri - lindore me parcelën kadastrale nr.273-48 ZK Sapniq, në gjatësi prej 40.48m, në anën jug – lindore me parcelën kadastrale nr.273-4 ZK Sapniq, në gjatësi prej 17.88m, në anën jug – perëndimore me parcelën kadastrale nr.273-3 ZK Sapniq, në gjatësi prej 57.40m, si dhe në anën veri – perëndimore me parcelën kadastrale nr.273-48 ZK Sapniq, në gjatësi prej 9.55m.

III. VËRTETOHET se paditësi S (I) G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.00273-3, ZK Sapniq, pronë private, vendi i quajtur “Rezina”, me kulturë ”Bujqësore - Arë e klasës 6”, në sipërfaqe të përgjithshme tekstuale prej 5346 m², e cila kufizohet në anën lindore me parcelën kadastrale nr.273-2, në gjatësi prej 57.40m, në anën jugore me parcelën kadastrale nr.273-4, në gjatësi prej 27.43m +33.81m + 17.01m = 78.25m, në anën perëndimore me parcelën kadastrale nr.273-1, në gjatësi prej 20.91 + 33.68m + 11.57 + 16.16m =82.32m, si dhe në anën veriore me parcelën kadastrale nr.273-48, në gjatësi prej 75.24m.

IV. DETYROHEN të paditurat G (I) M, e lindur K, S (I) K, M (I) K, M.S, Sh.R, dhe A.H, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë nr.00273-2, ZK Sapniq dhe nr.00273-3, ZK Sapniq, në emër të paditësit në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi S (I) G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurave G (I) M, e lindur K, S (I) K, M (I) K, M.S, Sh.R, dhe A.H, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në paluatjshmërinë - parcelën me numër 00273-2, ZK Sapniq dhe parcelën me numër 00273-3, ZK Sapniq.

Paditësi si në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar faktin se paditësi nga paraardhësi i të paditurve me kontratë gojore mbi shitblerjen e paluajtshmërisë ka blerë parcelat kadastrale me shënime si në padi. I njëjti ka theksuar se paditësi i ka kryer të gjitha prestimet nga paraardhësi i të paditurve, ku këtë fakt të paditurit nuk e kontestojnë, po ashtu paraardhësi i të paditurve që nga viti 1985, ia ka dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim të lirë parcelat këtu paditësit dhe që nga ajo kohë nuk është penguar nga askush. Për t'u vërtetuar ky fakt, gjykatës i ka propozuar që ta angazhojë ekspertin e gjeodezisë, që së bashku me gjykatën të dalë në vend për të bërë identifikimin e parcelës. I njëjti ka theksuar se duke marr për bazë faktin se, gjykata, gjatë procedurës së provave, e sidomos gjatë daljes së gjykatës në terren, së bashku me ekspertin e gjeodezisë, për të bërë identifikimin e parcelave në fjalë, po ashtu edhe nga deklarimi i të paditurit 4, M.K, njëherit i autorizuar i të paditurve të tjerë, i cili nuk ka kundërshtuar pretendimet e paditësit, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, si në padi, në atë mënyrë që vërtetohet se paditësi S.I.G nga fshati Sapniq, është pronar në bazë të parashkrimit fitues, i parcelave të cekura, me shënimet si në padi, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të LPDTS-së.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri M.K, i cili njëkohësisht është edhe përfaqësues i autorizuar i të paditurve të tjerë në përgjigjen në padi dhe seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se janë të vërteta deklaratimet e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit se paraardhësi i tyre I.K ia ka shitur parcelat kontestuese paditësit, si dhe në emrin e tij si i paditur dhe në emrin e të paditurve të tjerë, e pohon kërkesëpadinë e paditësit, ku pas administrimit të provave, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët

ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

1. Certifikatën e pronës, me nr. të lëndës 08-942/03-0009987/22, e datës 28.02.2022;
2. Dëshmi vdekje, e përpiluar me datë 27.08.2016, për të ndjerin I.K;
3. Dëshmi vdekje, me nr. 03-200/01-0045280/23, e datës 19.10.2023, për të ndjerën Z.S;
4. Ekspertizën e gjeodezisë, e ekspertit A.M, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 12.06.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar duke qenë se të paditurit e kanë pohuar kërkesëpadinë, që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, ku i padituri M (I) K personalisht e ka pohuar kërkesëpadinë, ndërsa të paditurit G (I) M, e lindur Kafexhiu, S (I) K, M.S, Sh.R, dhe A.H pohimin e kërkesëpadisë e kanë bërë përmes të paditurit M (I) K, i cili njëkohësisht është edhe përfaqësues i autorizuar i tyre.

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë 08-942/03-0009987/22, e datës 28.02.2022, e datës 28.02.2022 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 12.06.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela kadastrale nr. 00273-2 Zona Kadastrale Sapniq, me sipërfaqe prej 460 m² dhe parcela kadastrale nr. 00273-3 Zona Kadastrale Sapniqi, me sipërfaqe prej 5346 m² evidentohet në emër të të ndjerit I (M) K(paraardhës i të paditurve F.M e lindur K, S.K, M.K, M.S, Sh.R, dhe A.H)), me pjese ideale 1/1.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga të paditurat, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thëniet në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që paditësit janë të evidentuara si pronare të paluajtshmërive, që vërtetohet përmes certifikatës së pronës me nr. 08-942/03-0009987/22, e datës 28.02.2022.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve përmes të autorizuarit të tyre, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë*

kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)”, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk kishte kërkuar shpenzimet procedurale, në kuptim të nenit 450 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.915/2022 më datë 19.07.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.